VENDIM
Nr. 50, datë 6.9.2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR FUNKSIONET E STRUKTURAVE DREJTUESE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES PËR ADMINISTRIMIN E REZERVËS VALUTORE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "f" dhe "m", të nenit 53, paragrafi 4 dhe të nenit 63, paragrafët 1 dhe 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për funksionet e strukturave drejtuese në procesin e vendimmarrjes për administrimin e rezervës valutore", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Komiteti i Investimit në Bankën e Shqipërisë.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet rregullorja "Mbi funksionet e strukturave drejtuese në procesin e vendimmarrjes për administrimin e rezervës valutore", miratuar me vendimin nr. 43, datë 14.6.2006, të Këshillit Mbikëqyrës.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi dhe rregullores përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i funksioneve të strukturave drejtuese dhe njësive organizative përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë, gjatë procesit të vendimmarrjes për adminis-trimin e rezervës valutore.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në përputhje dhe në zbatim të:
a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe
b) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
a) Administrator i brendshëm i rezervës valutore – është Departamenti i Operacioneve Monetare.
b) Administrator i jashtëm i rezervës valutore – është subjekt jashtë strukturës organizative të Bankës së Shqipërisë, me të cilat Banka e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për administrimin e një pjese të rezervës.
c) Banka – është Banka e Shqipërisë.
d) Departamenti – është Departamenti i Operacioneve Monetare.

e) Transh – është pjesa e fondit të rezervës e krijuar në bazë të një ose disa kritereve specifike.

f) Horizont kohor – është periudha kohore që lidhet me arritjen e një objektivi të procesit të administrimit të rezervës.

g) *Benchmark* – është portofoli teorik, i cili përzgjidhet në përputhje me shkallën e rrezikut të pranuar nga Banka dhe që shërben si bazë krahasimi në analizën e rezultatit të investimit.

h) Rezultati – është një tregues që përfaqëson kthimin e portofolit krahasuar me kthimin e *benchmark*-ut, të korrigjuar me rrezikun e mbartur.

i) Shkalla e rrezikut e lejuar – është pranimi i vullnetshëm i një shkalle të caktuar të rrezikut.

j) Shpërndarja e rrezikut të lejuar – është procesi i vendosjes së kufizimeve lidhur me masën e rrezikut që mund të merret përsipër nga administratori i brendshëm dhe i jashtëm.

k) Interval besimi – është intervali i cili me një probabilitet të dhënë përmban parametrin që synohet të vlerësohet.

l) Ndërmjetës financiarë – janë institucione financiare që ndërmjetësojnë në tregtimin e titujve, të instrumenteve derivative, të instrumen-teve të tregut të parasë, si dhe institucione të tjera me të cilat veprohet për qëllime të administrimit të rezervës valutore.

m) Rezervë – nënkupton atë pjesë të rezervave valutore që plotëson njëkohësisht kushtet: i) është pjesë e bilancit të Bankës, ii) është në formë likuide, iii) administrohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, në cilësinë e administratorit të brendshëm, si dhe nga administratori i jashtëm i Bankës.

n) Komiteti i Investimit – është organi kolegjial që ka si qëllim të sigurojë zbatimin e politikës së investimit për administrimin e rezervës valutore, detyrat e të cilit përcaktohen në një rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 4

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës miraton rregulloren "Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore", në të cilën formulohen qëllimet, objektivat dhe kriteret e përgjithshme të administrimit të rezervës.

2. Në funksion të miratimit të politikës dhe mënyrës së administrimit të rezervës, Këshilli Mbikëqyrës në lidhje me:

a) *Qëllimet dhe objektivat* – përcakton qëllimet e mbajtjes së rezervës dhe vendos objektivat e administrimit të rezervës.

b) *Strukturën e rezervës* – vendos kriteret për organizimin e rezervës në transhe në përputhje me objektivat e administrimit të këtij fondi.

c) *Përbërjen e rezervës sipas monedhave* – vendos kriteret për përcaktimin e përbërjes sipas monedhave të secilit prej transheve të rezervës në përputhje me objektivat e administrimit të rezervës.

d) *Rrezikun e tregut* – miraton kthimin minimal nga investimi i rezervës që Banka mund të pranojë, gjatë horizontit kohor të përzgjedhur, me një interval besimi të caktuar, me synim maksimizimin e kthimit vjetor në periudhën afatgjatë.

e) *Rrezikun e kreditit* – përcakton nivelin minimal të pranuar të renditjes sipas cilësisë së kreditit të subjekteve (të borxhit të emetuar prej tyre, nëse nuk ka renditje të subjektit), me të cilat investohet rezerva gjatë administrimit të saj.

f) *Instrumentet financiare të lejuara* – miraton llojet e instrumenteve financiare në të cilat investohet rezerva gjatë administrimit të saj.

g) *Rrezikun e pranuar gjatë administrimit aktiv* – vendos nivelin maksimal të pranuar të humbjes së portofolit kundrejt *benchmark*-ut gjatë një viti financiar.

h) *Përzgjedhjen e institucioneve financiare* – vendos kriteret e përzgjedhjes së institucioneve financiare për kujdestarinë e mjeteve, për administrimin e rezervës nga administratori i jashtëm, si dhe të ndërmjetësve financiarë.

i) *Administrimin e rreziqeve të tjera* – sipas nevojës cakton detyra dhe miraton procedura për minimizimin e rreziqeve të përmendura më lart apo dhe të rreziqeve të tjera të konstatuara gjatë administrimit të rezervës.

3. Këshilli Mbikëqyrës informohet në mënyrë periodike, jo më rrallë se çdo tremujor, mbi ecurinë e procesit të administrimit të rezervës, përmes raportimeve që paraqiten nga Komiteti i Investimit. Në përmbajtje të raportimit jepet informacion të paktën mbi sa vijon:

a) madhësia dhe përbërja sipas monedhave e transheve të rezervës;

b) ecuria e treguesve të rrezikut në nivel transhi;

c) kthimi absolut dhe kthimi relativ (kundrejt *benchmark*-ut) i portofolave të administruar nga administratori i brendshëm dhe i jashtëm;

d) rezultati nga investimi i rezervës kundrejt atij të pasqyruar në bilanc;

e) zhvillimet në cilësinë e kreditit të emrave të lejuar për investim, shpërndarja e portofolit total të rezervës sipas emetuesit dhe sipas renditjes së cilësisë së kreditit;

f) ecuria e respektimit të kufizimeve të miratuara;

g) vendimet e marra nga Komiteti i Investimit.

Neni 5

Kompetencat e Guvernatorit

Guvernatori, në përputhje edhe me aktet e tjera nënligjore, në funksion të administrimit të rezervës miraton:

a) Rregullat për procedurat për përzgjedhjen e subjekteve me të cilat investohet rezerva, sipas nenit 4, pika 2, shkronja "e" dhe të institucioneve financiare me të cilat veprohet gjatë adminis-trimit të rezervës, sipas nenit 4, pika 2, shkronja "h".

b) Përbërjen e Komitetit të Investimit.

c) Listën e nëpunësve të autorizuar për të vepruar me institucionet financiare në emër të Bankës së Shqipërisë, në rastet kur kërkohet një e tillë nga ana e tyre.

Neni 6

Kompetencat e Komitetit të Investimit

1. Komiteti miraton dokumentin "Procedurat Operacionale të Investimit", i cili ka në përmbajtje tregues sasiorë në zbatim të parimeve dhe kritereve cilësore të miratuara në politikën për investimin e rezervës.

2. Komiteti i Investimit, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 2 të kësaj rregulloreje, në lidhje me:

a) *Strukturën e rezervës* – vendos madhësinë, përbërjen dhe shmangien e lejuar sipas monedhave të secilit prej transheve në të cilat është organizuar rezerva, si dhe kalimin e fondeve nga njëri transh në tjetrin.

b) *Benchmark*-ët – miraton për secilin portofol të rezervës *benchmark*-un e ekspozimit ndaj rrezikut të normave të interesit në përputhje me kriteret e parashikuara.

c) *Rrezikun e kreditit* – përzgjedh dhe vendos kufizime për emetuesit, në përputhje me nivelin minimal të pranuar të renditjes sipas cilësisë së kreditit të subjekteve (të borxhit të emetuar prej tyre, nëse nuk ka renditje të subjektit).

d) *Instrumentet financiare të lejuara* – bazuar në llojet e miratuara të instrumenteve financiare, vendos për instrumentet financiare që mund të përdoren për investim përkatësisht nga administratori i

brendshëm apo i jashtëm. Përcakton kufizime për investim në instrumente financiare.

e) *Shpërndarjen e rrezikut të lejuar gjatë administrimit aktiv* – shpërndan buxhetin e miratuar të rrezikut midis administratorit të brendshëm dhe atij të jashtëm, bazuar në pritshmërinë për rezultatin e tyre.

f) *Miratimin e institucioneve financiare* – përzgjedh institucionet financiare për kujdestarinë e mjeteve, administrimin e rezervës nga administratori i jashtëm, si dhe ndërmjetësve financiarë në përputhje me kriteret e miratuara. 3. Komiteti i Investimit siguron që struktura e rezervës sipas transheve dhe përcaktimi i portofolave *benchmark*-ë të jetë në përputhje me kriteret e miratuara dhe objektivat e adminis-trimit të rezervës.

4. Komiteti i Investimit me qëllim ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse të parashikuar në pikën 2, shkronja "e" të këtij neni, analizon periodikisht, rezultatin e administrimit aktiv të portofolave kundrejt *benchmark*-ëve të miratuar.

Neni 7

Kompetencat e Departamentit

1. Departamenti zbaton detyrat e parashikuara për realizimin e funksionit të administrimit të rezervës në përputhje me parimet, kriteret dhe kufizimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Komiteti i Investimit. Departamenti raporton çdo muaj në Komitetin e Investimit mbi ecurinë e procesit të administrimit të rezervës.

2. Në përputhje me rregulloren "Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare", aktet e tjera nënligjore, si dhe manualet e brendshme të departamentit:

a) Drejtori i Departamentit:

i. shqyrton raportimet periodike të përputh-shmërisë me treguesit e rrezikut dhe të rezultatit të investimit të përgatitura nga Sektori i Analizës dhe Administrimit të Rreziqeve.

ii. Vendos për ndarjen, me qëllim administrimin, të portofolave të rezervës mes specialistëve të administrimit të rezervës.

iii. Kryen shpërndarjen e rrezikut të lejuar gjatë administrimit aktiv, midis specialistëve të administrimit të rezervës, bazuar në rezultatin e arritur prej tyre gjatë procesit të investimit dhe miraton kufizimet përkatëse.

iv. Vendos për kufizime apo çështje të tjera operacionale të konstatuara gjatë aktivitetit ditor të Departamentit dhe që ndërthuren me administrimin e rezervës.

v. Nënshkruan kontratën midis Bankës së Shqipërisë dhe një institucioni financiar, në rastet kur kjo kërkohet për qëllime të administrimit të rezervës.

b) Sektori i Operacioneve, Zyra e Administrimit të Rezervës Valutore, ndjek zhvillimet në tregjet e jashtme dhe realizon veprimet e nevojshme për investimin e portofolave të rezervës duke u pozicionuar kundrejt *benchmark*-ëve brenda kufizimeve të miratuara për shkallën e rrezikut.

c) Sektori i Analizës dhe Administrimit të Rreziqeve realizon vlerësime për ndërtimin e portofolit strategjik të rezervës dhe angazhohet për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për administrimin e saj, vlerëson dhe ndjek rreziqet që mbarten gjatë procesit të administrimit dhe raporton mbi ecurinë e këtij procesi në nivelet drejtuese.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko